

Sylabus: Gjuhë gjermane VI

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Gjuhë gjermane VI
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i III-të, semestri i VI
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Vjosa Hamiti
Të dhënat kontaktuese:	vjosa.hamiti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda zhvillohet në vazhdimësi të lëndës “Gjuhë gjermane V” dhe synon zhvillimin e shkathtësive komunikative dhe sociale të nevojshme për komunikim në një gjuhë: të shkruarit, të lexuarit, të folurit dhe të dëgjuarit; përvetësimin e njohurive për strukturën e gjuhës; sensibilizimin për aspektet ndërkulturore. Ushtrohen strategji të ndryshme të të lexuarit (global, selektiv e të detajuar), fjalori zgjerohet me shprehje më komplekse të nivelit C 1. Gjatë ligjëratave trajtohen struktura gramatikore në nivelin C 1; ushtrohen shkathtësitë produktive (tiparet e llojeve të ndryshme të teksteve, të folurit) dhe ato receptive. Të katër shkathtësitë do të ushtrohen përmes trajtimit të temave ndryshme. Njëkohësisht bëhet pasurimi i fjalorit të studentëve me fjalë e konstrukte fjalish që përdoren gjatë komunikimit. Për zhvillimin e mësimin do të përdoren krahas teksteve nga libri bazë edhe tekste autentike që ndërliken me përditshmërinë, gramatikat e gjuhës gjermane për të huaj, CD-të për ushtrimin e shkathtësisë së të dëgjuarit, etj.</p>

Qëllimet e lëndës:

- zhvillimi i shkathtësive receptive dhe produktive të studentit në nivelin C1 të Kornizës së Përbashkët Evropiane;
- t'i mundësohet studentit të bëhet përdorues eficient dhe fleksibil i gjuhës gjermane si për qëllime personale ashtu edhe për ato profesionale;
- të ngrisë vetëbesimin e studentëve dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me folësit burimorë dhe jo burimorë të gjermanishtes;
- të zhvillojë shkathtësitë studiuuese të studentëve dhe shkathtësitë për mësimin e gjuhës;
- t'i aftësojë studentët të kombinojnë gjuhën me shkathtësitë reale jetësore;
- të inkurajohet mësim nxënia e pavarur.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje:

- të komunikojnë me folësit burimorë dhe ata jo-burimorë të gjermanishtes me gojë dhe me shkrim me vetëbesim, saktësi dhe rrjedhshmëri në nivelin C1;
- të hartojnë lloje të ndryshme të teksteve;
- të përdorin shkathtësitë e tyre ndër personale në kontekste të ndryshme;
- të përdorin mendimin kritik në situata të ndryshme.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	3.35
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	2	15	30

Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	30
Përgatitja për provimin final	6	4	24
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	15
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			162.35: 25= 6.494 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies: Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve, Përdoren metoda të kombinuara dhe qasje komunikative dhe ndërkulturore për ta arritur qëllimin: përmirësimin e shkathtësive receptive dhe produktive gjuhësore. Përmes metodës bashkëbiseduese punohet në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe. Në pjesën teorike të lëndës trajtohen elemente të caktuara të strukturës gramatikore të gjermanishtes që janë në funksion të realizimit të komunikimit. Studentët duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim, të punojnë vazhdimisht gjatë semestrit (detyra të shtëpisë) edhe në mënyrë të pavarur.

Metodat e vlerësimit: Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%.
Vijueshmëria e studentit 10%;
Kolloquium I 45%
Kolloquium II 45%

Literatura primare:

Ligjerata:

1. DUDEN 4 (2022): Die Grammatik. Mannheim. Wien. Zürich. Leipzig.
2. Helbig/Buscha (2013): Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht. Leipzig.
3. Hentschel, Elke/ Weydt, Harald (2013): Handbuch der deutschen Grammatik, Berlin
4. Karin Hall/Barbara Schneider (2013): Übungsgrammatik für Fortgeschrittene DaF.

Ushtrime:

1. Koithan U., Schmitz H., Sieber T., Sonntag R., Lösche R. (2008). Aspekte. Lehrbuch 3. Berlin u.a.: Langenscheidt
2. Koithan U., Schmitz H., Sieber T., Sonntag R., Lösche R. (2008). Aspekte. Arbeitsbuch 3. Berlin u.a.: Langenscheidt
3. Dreyer/Schmitt (2013): Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik, Neubearbeitung, Lehr- und Übungsbuch: 'Die neue Gelbe'. Neubearbeitung. Ismaning/München.
4. Helbig/Buscha (2006): Übungsgrammatik. Leipzig.

Literatura shitesë:

1. Habermann, Mechtild / Diewald, Gabriele/ Thurnaur, Maria (2009) : DUDEN - Fit für das Bachelorstudium: Grundwissen Grammatik für Sprachstudiengänge
2. Zifonun,G/ Hoffmann,L / Stecker, B. , (1997): Grammatik der deutschen Sprache ,1, 2, 3 , Berlin/New York,
3. Eisenberg, Peter(2013): Grundriss der deutschen Grammatik/Das Wort, Stuttgart
4. Eisenberg, Peter(2013): Grundriss der deutschen Grammatik/Der Satz, Stuttgart
5. Engel, Ulrich (2004): Deutsche Grammatik, München Ismaning/München.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Njoftimi me sylabusin.
Java 2:	<u>Konjunktiv II</u> -Die Formen des Konjunktivs II -Bedeutung und Gebrauch des Konjunktivs II -Das Umkehrverhältnis Indikativ und Konjunktiv
Java 3:	<u>Konjunktiv II</u> -Der Konjunktiv II als Ausdruck der Höflichkeit -Irreale Wunschsätze -Irreale Konditionalsätze
Java 4:	<u>Konjunktiv II</u> -Irreale Komparativsätze -Irreale Konsekutivsätze -Der Konjunktiv II in Relativ-Sätzen
Java 5:	<u>Konjunktiv I</u> Die Formen des Konjunktivs I -Der Gebrauch des Konjunktivs
Java 6:	<u>Konjunktiv I</u> -Die indirekte Rede -Berichtete Rede
Java 7:	<u>Kolloquium II</u>
Java 8:	<u>Modalverben:</u> Modalverben Der Gebrauch der Modalverben Modalverben in objektiver Aussage
Java 9:	<u>Modalverben:</u> -Modalverben in subjektiver Aussage

Java 10:	<u>Modalverbähnliche Verben mit dem Infinitiv:</u> -Modalverbähnliche Verben mit dem Infinitiv ohne <i>zu</i>
Java 11:	<u>Modalverbähnliche Verben mit dem Infinitiv:</u> - Modalverbähnliche Verben mit dem Infinitiv mit <i>zu</i> - Seminararbeit
Java 12:	<u>Nominalisierung -Verbalisierung</u> <u>Nominalstil- Verbalstil</u> -Die Nominalisierung verbaler Ausdrücke - Seminararbeit
Java 13:	<u>Nominalisierung -Verbalisierung</u> <u>Nominalstil- Verbalstil</u> -Die Verbalisierung nominaler Ausdrücke - Seminararbeit
Java 14:	<u>Infinitivsätze</u> -Infinitivsätze im Präsens und Perfekt -Infinitiv-Satz oder dass-Satz -Die Stellung des Infinitivsatzes
Java 15:	<u>Kolloquium II</u>

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.